

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BELSH

DREJTORIA E SHËRBIMEVE FINANCIARE E TË ARDHURAVE VENDORE
ZYRA E NDIHMËS EKONOMIKE

Nr. 340 Prot.

Belsh më 04.02.2026

PROJEKT-VENDIM

Për propozim për dhënien e Ndihmës Ekonomike për periudhën 01.01.2026- 31.01.2026

Bazuar në nenin 21 të ligjit nr 9355, datë 10.03.2005, i ndryshuar me Nr 57/2019 "Për ndihmën ekonomike dhe shërbimet shoqërore", i ndryshuar i cili parashikon që "Këshilli i Bashkisë Belsh ka të drejtë të miratojë kritere specifike për dhënien e ndihmës ekonomike me fondet e buxhetit vendor, dhe deri në 6% të fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike për familjet me më shumë pjeshtarë ose familjet në nevojë ". Zyra e ndihmës ekonomike bazuar dhe në verifikimet e bëra nga ana jonë **propozojmë dhe konkludojmë** të përfitojnë ndihmë ekonomike për muajin **JANAR 2026 për Bashkinë**, me një fond për _____ familje, një fond prej _____ lekë.

Fondi i Bashkisë për familjet në nevojë .

Lista e familjeve të cilat ne propozojmë të përfitojnë ndihmë ekonomike janë familje ekstremisht të varfëra dhe nuk janë përzgjedhur për të përfutuar nga sistemi pilot i NE për shkak të sistemit të ri të pikëzimit.

PËRGJEGJËSE NE
Entela DERVISHI



KRYETARI I BASHKISË
Arif TAFANI



Adresa: Qarku Elbasan, Belsh Qender, Rruga Haziz Dervishi,

bashkiabelsh@hotmail.com

Bashkia BELSH

Lista e bordoros JANAR 2026 Projekt-Vendimit në total të familjeve të propozuara për të përfituar me 6% e fondit të bllok-ndihmës për periudhën **1-31.01.2026**

Nr	Njësia Administrative	Numri familjeve	Fondi
1	Belsh	15	61583
2	Grekan	5	19382
3	Kajan	5	23956
4	Rrasë	1	37023
5	Fierzë	0	0
	Totali	26	108624

PËRGJEGJËSE NE
Entela DERVISHI



KRYETAR I BASHKISË
Arif TAFANI



Adresa: Qarku Elbasan, Belsh Qender, Rruga Haziz Dervishi,

bashkiabelsh@hotmail.com

LISTË PAGESA E PERSONAVE QË PAGUIHEN NË SKEMËN E 6 % PËR MUAJIN JANAR 2026

Nr	Emri i Aplikantit	Admin parave	Vlera e përlogaritur për fondin 6%	Kompensimi i Energjisë	Totali	NID Admin parave
1	Lumturi Ramazan Ahmeti	Lumturi Ramazan Ahmeti	2178.00	1288.00	3466.00	H65621010P
2	Ferit Beqir Sina	Nafije Sali Sina	1525.00		1525.00	G65628009W
3	Besim Riza Sina	Zyhra Idriz Sina	2178.00		2178.00	F85525018E
4	Sajde Ymer Paja	Sajde Ymer Paja	2178.00		2178.00	H05201011U
5	Elona Xhevit Zekthi	Elona Xhevit Zekthi	3267.00		3267.00	I75416023R
6	Muin Shyqyri Pepa	Sanije Murat Pepa	3703.00	1288.00	4991.00	G65822007F
7	Shqipe Ali Abazi	Shqipe Ali Abazi	2178.00	1288.00	3466.00	H35710011O
8	Kujtim Ramazan Ahmeti	Hamide Xhevit Ahmeti	3703.00		3703.00	G76208004L
9	Anxhela Avni Dervishi	Anxhela Avni Dervishi	5940.00		5940.00	J75622011I
10	Manjola Bajram Hysa	Manjola Bajram Hysa	8712.00		8712.00	I95603009R
11	Edlira Ferit Muça	Edlira Ferit Muça	1525.00		1525.00	H85202013D
12	Marsida Shefqet Zekthi	Marsida Shefqet Zekthi	1980.00		1980.00	J06124010N
13	Manushaqe Veiz Uruçi	Manushaqe Veiz Uruçi	7920.00		7920.00	I25511012V
14	Besim Ramadan Dyrmyshi	Zamira Demir Dyrmyshi	4792.00		4792.00	I45416019J
15	Albana Aqif Hysa	Albana Aqif Hysa	5940.00		5940.00	H96031005Q
16	Kristina Bajram Skënderi	Kristina Bajram Skënderi	5940.00		5940.00	J95627010E
17	Anxhela Shefqet Senia	Anxhela Shefqet Senia	5940.00		5940.00	J66104014U
18	Taulant Qani Lleshi	Taulant Qani Lleshi	2178.00		2178.00	I50412016C
19	Myzejen Hazis Senia	Myzejen Hazis Senia	3146.00		3146.00	G55629011P

Adresa: Qarku Elbasan, Belsh Qender, Rruga Haziz Dervishi,

bashkiabelsh@hotmail.com

20	Dashurie Petrit Sinani	Dashurie Petrit Sinani	2178.00		2178.00	G65827050J
21	Rajmonda Ardjan Rusta	Rajmonda Ardjan Rusta	5940.00		5940.00	J55202010B
22	Florenc Ali Elezi	Zamira Rushan Elezi	6752.00		6752.00	I26103008M
23	Sonila Yzeir Koçiu	Sonila Yzeir Koçiu	5940.00		5940.00	J85221010H
24	Saide Qamil Karaj	Saide Qamil Karaj	3146.00		3146.00	G05605019A
25	Fatime Xhaferr Xhafa	Fatime Xhaferr Xhafa	2178.00		2178.00	G65526008B
26	Arta Xhevit Meta	Arta Xhevit Meta	3703.00		3703.00	H95405017L
26			104760.00	3864.00	108624.00	

PËRGJEGJËSE NE
Entela DERVISHI



KRYETARI BASHKISË
Artif TAFANI



Adresa: Qarku Elbasan, Belsh Qender, Rruga Haziz Dervishi,

bashkiabelsh@hotmail.com



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BELSH
DREJTORIA E SHËRBIMEVE FINANCIARE E TË ARDHURAVE VENDORE
ZYRA E NDIHMËS EKONOMIKE

Nr. ____ Prot .

Belsh më ____ . ____ .2026

RELACION DREJTUAR KESHILLIT BASHKIAK .

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës së nënve 12, pikat 1, 4, 5 të ligjit nr. 9355 datë 10.03.2005 Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore , të ndryshuar të Vendimit nr. 57 datë 04.09.2019 të Këshillit të Ministrave për përcaktimin e procedurave të dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike Kreu IV “Përdorimi i fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike” ku thuhet se :Këshilli Bashkiak ka të drejtë të miratojë dhënie të ndihmës ekonomike për familjet që nuk janë përfituese nga sistemi i pikëzimit , duke përdorur deri në 6% nga fondi i kushtëzuar për bllok ndihmë ekonomike.

Kërkojmë që Këshilli Bashkiak të miratojë këtë Projekt -vendim të sjellë nga zyra jonë.

Faleminderit për bashkëpunimin!

PËRGJEGJËSE NE:

Entela DERVISHI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BELSH
AGJENSIA E FUNKSIONEVE TE PATRANSFERUESHME
DREJTORIA E MBROJTJES CIVILE
SEKTORI I EMERGENCAVE CIVILE, DHE STREHIMIT

Nr 151 prot

Belsh me: 04.02.2026

PROJEKT-VENDIM

“ Për miratimin e vlerës financiare,të dëmeve shkaktuar nga rënia e zjarrit në banesën e z.Hyqmet Çarciu , banor i fshatit Dëshiran, Njësia Administrative Grekan si dhe shpërblimin e pjesshëm financiar nga fondi I kushtëzuar i Mbrojtjes Civile”.

Në zbatim të ligjit nr.139 datë 17/12/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, ligjit 45/2019 “Për Mbrojtjen Civile”, VKM nr.329 date 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare, për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, sektori i emergjencave ka bërë verifikimin në terren në objektin e **z.HyqmetÇarciu**ku ka konstatuar dëmtimin e objektit si dhe djegien e të gjitha orendive shtëpiake.Në këtë ngjarje tragjike si pasojë e zjarrit pronari humbi jetën në spitaline QSUT.

Bashkia Belsh për ti ardhur sadopak në ndihmëfamiljes së të ndjerit z. Hyqmet Çarciu i propozon Këshillit Bashkiak si më poshtë:

1. Miratimin e dokumentacionit tekniko ligjor të hartuar nga Bashkia Belsh.
2. Të miratojë vlerën financiare të dëmshpërblimit për dëmin e shkaktuar nga rënia e zjarrit në banesën **ez.Hyqmet Çarciu**, bazuar në V.K.M. nr. 329 datë 16.05.2012 e cila është sa shuma e 50% e vlerës së preventivit nga ana ndërtimore të përlllogaritur me 100% e preventivit të orendive shtëpiakebazuar në dëmet e shkaktuara. Dmth $(630914.54 \times 50\%) + 233475.6 \text{ lekë} = 548932.87 \text{ lekë}$ pra vlera e dëmshpërblimit për shtetasin **Z.Hyqmet Çarciu** është **548932.87lekë**.
3. Të miratojë dhënien e ndihmës sëpjesshme financiare Më shumën prej **548932.87lekë**, për familjen e **Z.Hyqmet Çarciu**.
4. Efekti financiar I pikës 3 do të perballohet nga Fondi I kushtëzuar I MbrojtjesCivile me kodin e produktit 9107 AB.

Konceptoi bazen ligjore:

Griselda Toska 
Specialiste e EC dhe Strehimit :
Emine Leka 

Drejtori i Agjensise :
Arsen HYS





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BELSH

AGJENSIA E FUNKSIONEVE TE PATRANSFERUESHME

DREJTORIA E MBROJTJES CIVILE

SEKTORI I EMERGENCAVE CIVILE, DHE STREHIMIT

Nr 152 prot

Belsh me: 04.03.2026

Relacion shpjegues

Në zbatim të ligjit nr.139 datë 17/12/2015 “ Për Vetëqeverisjen Vendore”, ligjit 45/2019 “Për Mbrojtjen Civile”, VKM nr.329 date 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare, për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”.

Në datën 28/08/2025 rreth orës 07 :10 në fshatin Dëshiran Njësia Administrative Grekan ka rënë zjarr në banesën e shtetasit **Hyqmet Çarçiu** i datëlindjes 02/03/1940 banues në fshatin Dëshiran Bashkia Belsh .Sipas të dhënave të administruara nga strukturat vendore dhe njoftimit të shërbimit të zjarrëfikses zjarri ka përfshirë të gjithë banesën duke shkaktuar dëme materiale dhe dëmtime serioze shëndetësore për pronarin e banesës.

Pas ndërhyrjes së shërbimit zjarrëfikës shtetasi u transportua menjëherë në spitalin e Elbasanit dhe më pas në QSUT Tiranë , por si pasojë e plagëve dhe dëmtimeve të marra nga flakët fatëkeqësisht ndërroi jetë në datën 29/08/2025 në ambjentet e spitalit .

Ky informacion bazohet në njoftimet e marra nga organet përgjegjëse dhe skeda e vdekjes e marrë nga spitali .

Bashkangjitur do të gjeni dosjen e plotë e të ndjerit Z.Hyqmet Çarçiu .

Konceptoi bazen ligjore :

Griselda Toska

Specialiste e EC dhe Strehimit :

Emine LEKA

Drejtori i Agjensise :

Arsen HYSA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BELSH

Nr 332 Prot

Belsh me : 04/02 /2026

PROJEKT –VENDIM

“Për miratimin e rinovimit të Kontratës së Shërbimit Publik të Pranimi, Depozitimit dhe Trajtimit të Mbetjeve të lidhur me shoqërinë “Eco-Elb” sh.a dhe Bashkinë Belsh”

Mbështetur në Kushtetutën Republikës së Shqipërisë; Ligjin Nr.139 datë 17/12/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligjit nr. 10463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” i amenduar me Ligjin nr. 156, datë 10.10.2013, VKM nr. 229, datë 23.04.2014, “Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe informacionin që duhet të përfshihet në dokumentin e transferimit”; Vendimit nr. 08, datë 19.05.2025 të Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë “ECO-ELB” sh.a., për ndryshimin e emimit të shërbimit; Kontratës së Shërbimit Publik për “Pranimin, depozitimin dhe trajtimin e mbetjeve”, nr. 337 Prot, datë 23.01.2025, lidhur ndërmjet Bashkisë Belsh dhe shoqërisë “ECO-ELB” sh.a., me propozimin e Kryetarit të Bashkisë Belsh,

PROPOZOJMË:

1. Miratimin e rinovimit të Kontratës së shërbimit publik për pranimin, depozitimin dhe trajtimin e mbetjeve me shoqërinë “ECO-ELB” sh.a., për periudhën 01.01.2026 – 31.12.2026.
2. Miratimin e zbatimit të emimit të ri të shërbimit sipas Vendimit nr. 08, datë 19.05.2025 të Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë “ECO-ELB” sh.a.
3. Autorizimin e Kryetarit të Bashkisë Belsh për nënshkrimin e aktit të rinovimit/amendimit të kontratës.
4. Ngarkohen Drejtoria e Shërbimeve Publike, mirembajtja e objekte publike/arsimore dhe transportit, Drejtoria e Shërbimeve Mbeshtetese dhe Drejtoria e Financës për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi

Bashkëngjitur relacioni shpjegues.

Faleminderit!

Pergj.Sek shërbimeve publike
Julgin Rika

Dr. E Shërbime Mbeshtetese
Anxhelina Qypi

KRYETARI I BASHKISË
Arif TAFANI





REPUBLIKA E KOSOVËS
BASHKIA BELSH

Nr _____ Prot

Belshmë: ____/____/2026

Lënda: **RELACION**

“PËR MIRATIMIN E RINOVIMIT TË KONTRATËS SË SHËRBIMIT PUBLIK ME SHOQËRINË
“ECO-ELB” sh.a.”

KËSHILLIT BASHKIAK BELSH.

Te nderuar keshilltarë!

Në zbatim të funksioneve të Bashkisë Belsh për garantimin e shërbimeve publike vendore, si dhe në kuadër të vijimësisë së shërbimit të pranimi, depozitimit dhe trajtimit të mbetjeve urbane, paraqitet për shqyrtim dhe miratim projekt-vendimi për rinovimin e kontratës së shërbimit publik me shoqërinë “ECO-ELB” sh.a.

Bashkia Belsh dhe shoqëria “ECO-ELB” sh.a. kanë lidhur Kontratën e Shërbimit Publik nr. 337 Prot, datë 23.01.2025, me objekt “Pranimin, depozitimin dhe trajtimin e mbetjeve”. Afati i kësaj kontrate ka përfunduar më datë 31.12.2025.

Shoqëria “ECO-ELB” sh.a., me shkresën nr. 555 Prot, datë 17.12.2025, dhe shkresën nr. 65 prot date 29.01.2026, ka kërkuar rinovimin e kontratës për vitin 2026, duke propozuar zbatimin e ëmimit të ri të shërbimit, të miratuar me Vendimin nr. 08, datë 19.05.2025 të Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë.

Rinovimi i kontratës synon të garantojë vijimësinë e shërbimit publik, pa ndërprerje, si dhe respektimin e detyrimeve kontraktuale ekzistuese ndërmjet palëve.

Projekt-vendimi është përgatitur në mbështetje të:

- Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;
- Ligjit nr. 10463/2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”;
- Kontratës ekzistuese të shërbimit publik;
- Vendimit nr. 08, datë 19.05.2025 të Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë “ECO-ELB” sh.a.

Për sa më sipër, propozohet miratimi i projekt-vendimit “Për miratimin e rinovimit të kontratës së shërbimit publik me shoqërinë “ECO-ELB” sh.a.”

Duke ju falenderuar, ju njoftojmë të miratoni këtë projekt-vendim.

Pergj.Sek sherbimeve publike
Julgin Rika

KRYETARI I BASHKISË
Arif TAFANI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BELSH

AGJENSIA E FUNKSIONEVE TE PATRANSFERUESHME

DREJTORIA E MBROJTJES CIVILE

SEKTORI I EMERGENCAVE CIVILE, DHE STREHIMIT

Nr 148 prot

Belsh me: 04.02.2026

PROJEKT-VENDIM

“Për miratimin e vlerës financiare të humbjes së jetës të Z.Hyqmet Çarçiu ,Fshati Dëshiran ,Bashkia Belsh dhe shpërblimin financiar sipas vkm 329 nga Fondi i kushtëzuar i Mbrojtjes Civile”

Në zbatim të ligjit nr.139 datë 17/12/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, ligjit 45/2019 “Për Mbrojtjen Civile”, VKM nr.329 date 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare, për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, sektori i Emergjencave në bashkëpunim me sektorin e MZSH ka bërë konstatimin e dëmeve materiale si dhe gjendjen shëndetësore të z. **Hyqmet Çarçiu** i cili ndërroi jetë si pasojë e plagëve të marra nga zjarri.

Bashkia Belsh për të ardhur në ndihmë familjes së të ndjerit z.Hyqmet Çarçiu i propozon Këshillit Bashkiak si më poshtë :

1.Të miratoj dhënien e ndihmës financiare sipas VKM.329,në shumën prej 500.000 (pesëqind mijë) lekë ,për familjen e të ndjerit.

Efekti financiar në pikën e parë do të përballohet nga Fondi i Kushtëzuar i Mbrojtjes Civile.

Bashkëngjitur do të gjeni të gjithë dosjen me dokumentacionin përkatës.

Ju faleminderit!

Konceptoi bazen ligjore:

Griselda Toska 
Specialiste e EC dhe Strehimit :
Emine Leka 

Drejtori i Agjensise :

Arsen HYSA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BELSH
AGJENSIA E FUNKSIONEVE TE PATRANSFERUESHME
DREJTORIA E MBROJTJES CIVILE
SEKTORI I EMERGENCAVE CIVILE, DHE STREHIMIT

Nr 149 prot

Belsh me: 04 . 02 .2026

Relacion shpjegues

Në zbatim të ligjit nr.139 datë 17/12/2015 “ Për Vetëqeverisjen Vendore”, ligjit 45/2019 “Për Mbrojtjen Civile”, VKM nr.329 date 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare, për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”.

Në datën 28/08/2025 rreth orës 07 :10 në fshatin Dëshiran Njësia Administrative Grekan ka rënë zjarr në banesën e shtetasit **Hyqmet Çarçiu** i datëlindjes 02/03/1940 banues në fshatin Dëshiran Bashkia Belsh .Sipas të dhënave të administruara nga strukturat vendore dhe njoftimit të shërbimit të zjarrëfikses zjarri ka përfshirë të gjithë banesën duke shkaktuar dëme materiale dhe dëmtime serioze shëndetësore për pronarin e banesës.

Pas ndërhyrjes së shërbimit zjarrëfikës shtetasi u transportua menjëherë në spitalin e Elbasanit dhe më pas në QSUT Tiranë , por si pasojë e plagëve dhe dëmtimeve të marra nga flakët fatkeqësisht ndërroi jetë në datën 29/08/2025 në ambjentet e spitalit .

Ky informacion bazohet në njoftimet e marra nga organet përgjegjëse dhe skeda e vdekjes e marrë nga spitali .

Bashkangjitur do të gjeni dosjen e plotë e të ndjerit Z.Hyqmet Çarçiu .

Konceptoi bazen ligjore :

Griselda Toska 

Specialiste e EC dhe Strehimit :

Emine LEKA 

Drejtori i Agjensise :

Arsen HYSA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BELSH

DREJTORIA EKONOMIKE DHE TE ARDHURAVE VENDORE DHE NDIHMA EKONOMIKE

Nr. ____ .Prot

Belsh më: ____ . ____ .2026

KËSHILLI I BASHKISË BELSH

Projekt -Vendim

Nr. ____ Date ____ / ____ 2026

Për miratimin e nxjerrjes jashtë përdorimi të aktiveve të trupëzuara ose të patrupëzuara

Mbështetur në ligjin 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, udhëzimit nr.30 dr.27.12.2011 “Për menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, Urdhrit të Kryetarit të Bashkisë nr.439 dt. 20.10.2025 dhe Urdhrit me nr. 440 dt. 20.10.2025 “Mbi ngritjen e komisionit për inventarizimin e Aktiveve dhe Materialeve për vitin 2025” Drejtoria e Finances dhe te Ardhurave Vendore i Propozon Këshillit të Bashkisë Belsh:

Të miratojë Nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve dhe materialeve sipas llogarive përkatëse dhe tabelave bashkëngjitur.

Llogaria. 214 (Instalime teknike,makineri, pajisje, vegla pune) në vlerën = 1,868,967.4 Lekë
(Një milion e tetëqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e shtatë).

Llogaria 218 (Inventar ekonomik) në vlerën = 523,829 Lekë
(Pesëqind e njëzet e tre mijë e tetëqind e njëzet e nëntë).

Llogaria 327 (Objekt Inventari) në vlerën = 4,340,624.6 Lekë (Katër milion e treqind e dyzet mijë e gjashtëqind e njëzet e katër).

Llogaria 217 (kafshe pune e prodhimi) në vlerën = 288,000 Lekë (Dyqind e tetëdhjetë e tetë mijë).

Jurist Specialist Finance

Anxhelina YPI

Drejtore i Financës

Alban NIPOLLI

KRYETARI I BASHKISË

Arif TAFAN



**DREJTORIA EKONOMIKE DHE TE ARDHURAVE VENDORE DHE NDIHMA
EKONOMIKE**

RELACION

Mbi nxjerrjen jashtë përdorimi të aktiveve dhe materialeve (Inventar Ekonomik, Instalime teknike, Pajisje, Vegla Puna) për vitin 2025 ne Bashkine Belsh, Njësitë Administrative , Shkollat dhe institucionit Agjensia e Funksioneve te Patransferueshme .

Në bazë të Urdhërit të Kryetarit të Bashkisë nr. 439 dt. 20.10.2025 dhe nr.440 dt 20.10.2025 “Mbi ngritjen e komisionit për inventarizimin e Aktiveve dhe Materialeve për vitin 2025” është krijuar komisioni i inventarizimit ku janë bërë vleresimet dhe verifikimet për cdo Institucion, shkollë, kopështe etj.

Gjatë inventarizimit janë gjetur materiale të konsumuara që kanë humbur vlerën e përdorimit dhe për to janë mbajtur proceverbale përkatëse duke përcaktuar sasinë dhe cmimin si për inventarin ekonomik dhe për inventarin e imet për cdo institucion.

Në bazë të procesverbaleve të sjella për nxjerrjen jashtë përdorimit të materialeve që kanë humbur vlerën e tyre të përdorimit kryesisht inventar i imet, tavolina, karrige, stufa zjarri, materiale higjene etj. janë kryesisht në institucione arsimore si : Shkolla e mesme Belsh, Shkolla 9 Vjecare Marinëz, Dushk, Rrase si dhe në cdo Njësi Administrative, janë nxjerrë jashtë përdorimi për arsye së janë thyer ose dëmtuar në shkallë të tillë që është e pamundur të kthehet në gjëndje punë nëpërmjet riparimit, kanë humbur vlerën e përdorimit nga afati i gjatë dhe disa prej tyre janë materiale konsumi, nuk mund të riparohen dhe nuk mund të përshtaten për përdorim tjetër. Konkretisht me vlera sipas llogarive ekonomike paraqiten:

Llogaria 214 (Instalime teknike, vegla pune, pajisje) ne vleren = 1,868,967 lekë

Llogaria 218 (Inventar ekonomik) ne vleren = 523,829 lekë

Llogaria 327 (Objekt inventari) ne vleren = 4,340,624 lekë

Llogaria 217 (kafshe pune e prodhimi) ne vleren = 288,000 lekë

Të gjitha procesverbalet dhe dokumentacioni i inventarizimit ndodhet në Drejtorine e Finances se Bashkise Belsh.

Konceptoi:

Esma Zika

Drejtori:

Alban Nipolli

PROJEKT - VENDIM

“Për miratimin e disa ndryshimeve në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 54 datë 24.12.2025” Për miratimin e taksave dhe tarifave Vendore në Bashkinë Belsh për vitn 2026”

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, nenit 113 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, nenit 41 të ligjit nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, nenit 15, pika 3 të ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, si dhe nenit 27, pika 2 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, me propozim të Sektorit të Taksave,

PROPOZOJMË:

1. Miratimin e shkalles se taksës së ndikimit në infrastrukturë të jetë në masën 4% (katër për qind) të çmimit të shitjes për metër katror. Në rastin e ndërtimeve të destinuara për qëllime banimi apo për njësi tregtimi dhe shërbimi, të cilat kryhen nga shoqëri ndërtimi. Në këtë kategori investimesh përfshihen edhe ndërtimet zëvendësuese për qëllime banimi, të kushtëzuara për t’u ndërtuar si shkak i zbatimit të një kontrate koncesionare që prek banesat ekzistuese, si dhe ndërtimet e destinuara për qendra tregtare apo për qëllime biznesi.
2. Pjesët e tjera të Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 54, datë 24.12.2025, që nuk preken nga ky projekt-vendim, mbeten të pandryshuara.
3. Ngarkohet për zbatimin e këtij projekt -vendimi strukturat përgjegjëse , Sektori i Taksave vendore dhe DKTPMPP.

Bashkëngjitur relacioni shpjegues.

Faleminderit!

KRYETARI I BASHKISË

Arif TAFANI

Konceptoi:

P/Tatim-Taksave

Ditjon Pepa

Dr. Sherbimeve Mbeshtetese

Anxhelina Gypa





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BELSH

Nr. — Prot

Belshmë: 02/02/2026

Lënda: RELACION

KËSHILLIT BASHKIAK BELSH.

Te nderuar keshilltarë!

Në ushtrim të të drejtave të njohura për njësitë e qeverisjes vendore në parashikimet e ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar, nenit 113 të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", nenit 41 të ligjit nr. 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", nenit 15, pika 3 të ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", si dhe nenit 27, pika 2 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, me propozim të Sektorit të Taksave, Për projektvendimin "Për disa ndryshime në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 54, datë 24.12.2025, për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Belsh për vitin 2026"

Në nenin 27 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore në Republikën e Shqipërisë", citohet "Taksa e ndikimit në infrastrukturë 1. Baza e taksës është vlera në lekë e investimit të ri që kërkohet të kryhet sipas preventivit, ose vlera në lekë e çmimit të shitjes për metër katror të investimit të ri. Klasifikimi si investim i ri përcaktohet në përputhje me legjislacionin në fuqi për dhenien e lejes së ndërtimit. 2. Në rastin e ndërtimeve të destinuara për qëllime banimi apo për njësi tregtimi dhe shërbimi, të cilat kryhen nga shoqëri ndërtimi, shkalla e taksës së ndikimit në infrastrukturë është në masën 4 për qind deri në 8 për qind të çmimit të shitjes për metër katror. Në këtë kategori investimesh përfshihen edhe ndërtimet zëvendësuese për qëllime banimi, të kushtëzuara për t'u ndërtuar si shkak i zbatimit të një kontrate koncesionare, e cila prek banesat ekzistuese. Gjithashtu, në këtë kategori përfshihen edhe ndërtimet e destinuara për qendra tregtare apo të biznesit. Baza e taksës është vlera në lekë për metër katror e çmimit të shitjes së ndërtimeve për qëllime banimi apo të njësive të tregtimit dhe shërbimit....."

Ky projektvendim ka për qëllim përcaktimin e shkallës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për kategorinë e ndërtimeve të destinuara për qëllime banimi, njësi tregtimi dhe shërbimi, si dhe ndërtimet e destinuara për qendra tregtare apo biznesi. Propozimi synon unifikimin dhe qartësimin e nivelit të taksës, duke e përcaktuar atë në masën 4% të çmimit të shitjes për metër katror, në përputhje me kufijtë e përcaktuar nga legjislacioni në fuqi.

Vendosja e kësaj shkalle takse synon:

- Mbështetjen e zhvillimit të qëndrueshëm urban;
- Sigurimin e të ardhurave të nevojshme për përmirësimin e infrastrukturës vendore;
- Ruajtjen e një balance midis interesit publik dhe nxitjes së investimeve private.

Miratimi i këtij ndryshimi do të sjellë qartësi për subjektet ndërtuese dhe administratën vendore, si dhe do të ndikojë pozitivisht në rritjen e transparencës dhe efikasitetit në zbatimin e taksave vendore.

Duke ju falenderuar, ju njoftojmë të miratoni këtë projekt-vendim.

Konceptoi:
P.Tatim-Taksave
Dritjon Pepa





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BELSH

DREJTORIA EKONOMIKE DHE TE ARDHURAVE VENDORE

PROJEKT - VENDIM

NR. ____ .DT. ____ . ____ .2026

Mbi miratimin e Normatives së Harxhimit të Karburantit për vitin 2026

Në zbatim të ligjit 9936 datë 26.60.2008 “ Për menaxhimin e sistemit e Buxhetor në Republikën e Shqipërisë të Ligjit 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, të ligjit **nr.68/2017** dt.27.04.2017 “**Për Financat Vendore**”.

Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe të Ardhurave të Bashkisë Belsh i propozon Këshillit të Bashkisë Belsh si më poshtë:

Të miratojë normativat mbi konsumin e harxhimit të karburantit(**gazoil**) për mjetet qe janë në dispozicion të Bashkisë Belsh për vitin 2026 si më poshtë:

1. Automjeti “**Kamion Mercedes – Benz tip 17 – 19**” me 8 litra për një orë pune dhe 25 litra per 100km.
2. Kamioni i Transport Inertesh **Kamionit Astra 8445 HD7 84-45** me 12 litra për një orë pune dhe 35 litra per 100km .
3. Ekskavatori me zinxhirë **Tip VOLVO ECR88D** me 12 litra për një orë pune.
4. Vetura tip “**VOLKSWAGEN**” me 15 litra për 100 km, por jo më shume se 350 litra në muaj.
5. Kaldaja e Shkollës **9 – Vjeçare “Halit Uruci”** 15 lt për një orë.
6. Kaldaja e Shkollës së Mesme “**Sami Frasheri**” 30 lt për një orë
7. Zjarrfikëse **Tip “MAN”, targe EL 5580 B** me 12 litra për një orë pune dhe 35 litra për 100 km.
8. Zjarrfikëse **Tip “Renault” AA 873 DM** me 8 litra për një orë pune dhe 25 litra për 100 km.
9. **Traktor SD804** me 10 litra për një orë pune dhe 15 litra për 100 km.
10. **Makine Teknologjike** me 10 litra për një orë pune dhe 15 litra për 100 km .
11. Mjet Transporti **Kamioncine** me 13 litra për 100 km.
12. **Ambulance** me 15 litra për 100 km.
13. **Hyundai AB830VG** me 15 litra për 100 km, por jo më shume se 400 litra në muaj.
14. **Zjarrëfikese “Renault” AB981XA** me 12 litra për një orë pune dhe 35 litra për 100 km.

Përgjegjësi i Zyrës Juridike

Anxhelina Qypsi

Drejtori Financës

Alban Nipolli

Miratoi

Arif TAFANI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BELSH

DREJTORIA E SHËRBIMEVE FINANCIARE DHE TE ARDHURAVE VENDORE

Nr. ____ .Prot

Belsh më: ____ . ____ .2026

RELACION

“Mbi përcaktimin e normativës së harxhimit të karburantit për automjetet dhe pajisjet e Bashkisë Belsh për vitin 2026”

Në zbatim të ligjit nr.139/2015 “për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore dhe urdhrit të kryetarit nr.525 date 29.12.2025, ngriti komisionin për matjen e lëndës djegëse për automjetet/pajisjet që janë në pronësi të Bashkisë Belsh sipas inventarit 2025. Për secilën nga automjetet/ pajisjet është bërë prova e harxhimit të karburantit duke mbushur depozitën e karburantit plot dhe mbas 8 orëve pune ose pas 100 km rruge te kryer, është rimbushur sërish dhe në këtë mënyrë është përcaktuar norma e konsumit të lëndës djegëse për orë pune ose për km. Konstatimi është bërë në prezencë të komisionit bashkë me përgjegjës të secilës prej automjeteve/ pajisjeve sipas proces verbaleve me normativat e harxhimit përkatës , për secilën prej automjeteve/ pajisjeve te cilat gjenden pranë zyrës së financës.

Drejtore i Finances

Alban Nipolli

KRYETARI

Arif TAFANI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BELSH

Nr. 393 prot

Belsh më: 04/02/2026

PROJEKT-VENDIM

NR _____ DATË _____ .2026

**PËR MIRATIMIN E NISMËS PËR LIDHJEN E PAKTIT TË MIQËSISË NDËRMJET
BASHKISË BELSH DHE BASHKISË LUGO (REPUBLIKA E ITALISË)**

Në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", Bashkia Belsh paraqet për shqyrtim nismën për lidhjen e një Pakti Miqësie me Bashkinë Lugo, Republika e Italisë, me qëllim forcimin e bashkëpunimit ndërvendor dhe ndërkombëtar.

Kjo nismë mbështetet në lidhjet ekzistuese ndërmjet komuniteteve të dy qyteteve, si dhe në praninë e konsiderueshme të qytetarëve me origjinë nga Belshi në territorin e Bashkisë Lugo. Ajo synon krijimin e një kuadri bashkëpunimi institucional, kulturor, social dhe ekonomik, në funksion të zhvillimit lokal dhe interesit të përbashkët.

Miratimi i kësaj nisme paraqet rëndësi për qytetin e Belshit, pasi krijon mundësi për shkëmbim përvojash, promovim të territorit dhe forcim të lidhjeve me diasporën, si dhe hap rrugë për bashkëpunime të strukturuar në të ardhmen.

Propozojmë:

- Miratimin e nismës për lidhjen e Paktit të Miqësisë ndërmjet Bashkisë Belsh dhe Bashkisë Lugo (Republika e Italisë);
- Vijimin e procedurave institucionale për formalizimin e këtij bashkëpunimi, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.

Bashëlidhur do të gjeni Relacionin Shpjegues dhe draftin e Paktit të Miqësisë ndërmjet Bashkisë Belsh dhe Bashkisë Lugo.

Ju faleminderit,

KRYETARI I BASHKISË

ARIF TAFANI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BELSH

Nr. ____ prot

Belsh më: ____/____/2026

RELACION SHPJEGUES

Nisma për lidhjen e Paktit të Miqësisë ndërmjet Bashkisë Belsh dhe Bashkisë Lugo (Republika e Italisë) paraqitet për shqyrtim dhe miratim në Këshillin Bashkiak Belsh si një hap i rëndësishëm drejt forcimit të bashkëpunimit ndërkombëtar në nivel vendor.

Kjo nismë mbështetet në marrëdhëniet e krijuara ndër vite ndërmjet komuniteteve të dy qyteteve, si dhe në praninë e qëndrueshme të qytetarëve me origjinë nga Belshi në territorin e Bashkisë Lugo, të cilët kanë kontribuar në forcimin e lidhjeve shoqërore, kulturore dhe ekonomike ndërmjet dy komuniteteve.

Lidhja e një Pakti Miqësie synon krijimin e një kuadri të strukturuar bashkëpunimi në fusha me interes të ndërsjellë, si kultura, arsimi, rinia, sporti, turizmi dhe zhvillimi ekonomik lokal. Për Bashkinë Belsh, kjo nismë përfaqëson një mundësi për rritjen e kapaciteteve institucionale dhe për përfitimin nga përvoja e një bashkie të Bashkimit Evropian.

Përfitimet kryesore për qytetin e Belshit përfshijnë:

- shkëmbimin e përvojave dhe praktikave të mira në administrimin vendor;
- krijimin e mundësive për projekte të përbashkëta dhe akses në programe financimi kombëtare dhe evropiane;
- promovimin e vlerave kulturore, natyrore dhe turistike të territorit;
- forcimin e lidhjeve me diasporën dhe rritjen e përfshirjes së saj në zhvillimin lokal;
- nxitjen e shkëmbimeve kulturore, arsimore dhe rinore.

Miratimi i kësaj nisme nga Këshilli Bashkiak Belsh do të krijojë bazën institucionale për vijimin e procedurave të mëtejshme drejt lidhjes së Paktit të Miqësisë dhe ndërtimin e një bashkëpunimi afatgjatë në dobi të komunitetit lokal.

Ju faleminderit,

Kryetari I Bashkisë

Arif Tafani



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BELSH



REPUBLIKA E ITALISË
KOMUNA LUGO

DRAFT PAKT MIQËSIE

I nënshkruar në qytetin e Belshit, më : ____/____/____

Ne, Kryetarët e Bashkive të Lugo-s (Republika e Italisë) dhe Belsh-it (Republika e Shqipërisë),

- të bindur se po i përgjigjemi aspiratave të thella dhe nevojave reale të popullsisë tona përkatëse;
- duke afirmuar respektimin e të drejtave të njeriut si vlera të pacenueshme dhe të patjetërsueshme;
- të vetëdijshëm se ndërvarësia gjithnjë e në rritje ndërmjet shoqërive të ndryshme kombëtare kërkon një rend demokratik ndërkombëtar dhe global, i cili përbën themelin e paqes, dialogut dhe bashkëpunimit ndërmjet popujve;
- të bindur se lidhjet ndërmjet qyteteve evropiane përfaqësojnë një element thelbësor për zhvillimin e një qytetarie të bazuar në solidaritet, përfshirje dhe respekt të ndërsjellë;
- duke marrë parasysh praninë e fortë dhe historike, në territorin e Bashkisë së Lugo-s, të qytetarëve me origjinë nga Belshi, të cilët përbëjnë një komponent të rëndësishëm të strukturës sociale dhe ekonomike vendore dhe që, ndër vite, kanë kontribuar në konsolidimin e marrëdhënieve të miqësisë, integritetit dhe shkëmbimit ndërmjet dy komuniteteve;
- duke njohur vlerën e trashëgimisë njerëzore, shoqërore dhe kulturore të lindur nga këto marrëdhënie, si dhe vullnetin e përbashkët për ta vlerësuar dhe promovuar atë;
- duke marrë parasysh shkëmbimet institucionale të zhvilluara tashmë ndërmjet Administratave Bashkiake të Lugo-s dhe Belsh-it, të cilat kanë hedhur bazat për një bashkëpunim më të strukturuar dhe afatgjatë;
- duke riafirmuar vitalitetin dhe rëndësinë e arsyeve të përbashkëta që bashkojnë komunitetet tona;

vendosim, në këtë ditë, të nënshkruajmë një “Pakt Miqësie”, duke u angazhuar për të:

- ruajtur lidhje të përhershme ndërmjet Administratave Bashkiake përkatëse, duke promovuar dialogun institucional, shkëmbimin e përvojave dhe realizimin e veprimtarive të përbashkëta që synojnë përmirësimin reciprok në fushat e kompetencës përkatëse;
- inkurajuar dhe mbështetur shkëmbimet ndërmjet qytetarëve, duke favorizuar një kuptim më të thellë të ndërsjellë dhe një bashkëpunim efektiv, si shprehje e frymës së miqësisë dhe bashkëjetesës ndërmjet popujve;
- promovuar vlerat universale të lirisë, demokracisë, barazisë, përfshirjes dhe shtetit të së drejtës përmes nismave të përbashkëta dhe rrugëve të bashkëpunimit;
- bashkuar përpjekjet për të nxitur, në masën e plotë të mjeteve në dispozicion, zhvillimin e një bashkëpunimi të qëndrueshëm që kontribuon në paqe, prosperitet dhe përparim të komuniteteve përkatëse.

Të dyja palët do të nxisin realizimin e veprimtarive dhe iniciativave në fushat e mëposhtme:

- shkëmbimi i informacionit dhe praktikave të mira;
- bashkëpunime dhe projekte të përbashkëta ndërmjet institucioneve shkollore dhe realiteteve arsimore;
- organizimi i veprimtarive kulturore, ekspozitave dhe nismave artistike që synojnë vlerësimin e traditave dhe historisë së dy territoreve;
- promovimi i marrëdhënieve shoqërore, ekonomike dhe sportive;
- vlerësimi i burimeve turistike, natyrore dhe enogastronomike të dy qyteteve;
- vizita dhe itinerare njohëse në muze, monumente historike dhe vende me interes kulturor të pranishme në territoret bashkiake.

Qytetarët e të dy Bashkive do të përfshihen në veprimtari që synojnë:

- forcimin e ndjenjës së përkatësisë dhe njohjes së territorit;
- pjesëmarrjen aktive në dialog dhe shkëmbim mendimesh për realizimin e së mirës së përbashkët;
- krijimin e lidhjeve të reja dhe forcimin e atyre ekzistuese ndërmjet dy komuniteteve.

Palët angazhohen të ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme për të garantuar zbatimin e angazhimeve të marra me këtë Pakt Miqësie, edhe përmes pjesëmarrjes së përbashkët në programe dhe financime kombëtare dhe evropiane në fushat e kulturës, zhvillimit të qëndrueshëm dhe bashkëpunimit ndërkombëtar.

Ky Pakt Miqësie ka **kohëzgjatje të pakufizuar** dhe do të mbetet në fuqi për aq kohë sa palët do të vlerësojnë të ruajnë marrëdhënie vëllazërore dhe të promovojnë veprimtari të orientuara drejt së mirës së përbashkët dhe përparimit të komuniteteve përkatëse.

PËR BASHKINË BELSH
KRYETARI I BASHKISË

Z. Arif Tafani

PËR KOMUNËN LUGO
KRYETARIA E KOMUNËS

Znj. Elena Zannoni



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BELSH

DREJTORIA E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
SEKTORI I TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT

Nr. 836 Prot

Belsh, më: 04/02 2026

PROJEKT –VENDIM

“PËR

RISHIKIMIN E PROGRAMIT MODEL TË TRANSPARENCËS PËR BASHKINË BELSH”

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 " Për Vetëqeverisjen vendore", ligjit Nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, ligjit Nr.146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”, si dhe në zbatim të Urdhrit nr. 281, datë 30.12.2025 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, i cili është i detyrueshëm për të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore.

Në këtë kuadër, i propozojmë këshillit Bashkiak Belsh miratimin e projekt-vendimit për rishikimin e Programit Model të Transparencës të Bashkisë Belsh, me qëllim garantimin e së drejtës për informim, rritjen e transparencës institucionale dhe forcimin e llogaridhënies ndaj publikut.

Bashkëngjitur gjeni relacionin shpjegues dhe kopjen e Programit Model të Transparencës.

Ju faleminderit!

Konceptoi:

Koordinatorë për të Drejtën e Informimit

Fatmira BROSHKA

P/Spektori IT

Matea GJOSHI

Dr/ Drejtoria E Shërbimeve Mbështetëse

Anxhelina QYPI

KRYETARI I BASHKISË

Arif TAFANI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BELSH

DREJTORIA E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

SEKTORI I TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT

Nr. ____ Prot.

Belsh më: ____/____/2026

RELACION SHPJEGUES

Të nderuar këshilltarë!

Në zbatim të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", si dhe në përmbushje të detyrimeve që rrjedhin nga Urdhri nr. 281, datë 30.12.2025 i Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, i cili është i detyrueshëm për të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore, paraqitet për miratim në Këshillin Bashkiak të Belshit projekt-vendimi për rishikimin dhe miratimin e Programit Model të Transparencës.

Programi Model i Transparencës është një dokument standard, i hartuar dhe i miratuar nga Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, me qëllim garantimin e së drejtës për informim, rritjen e transparencës institucionale dhe përmirësimin e aksesit të publikut në informacion.

Bashkia Belsh ka miratuar dhe rishikuar Programin Model të Transparencës për herë të fundit në vitin 2024, sipas nenit 5 të Ligjit për të Drejtën e Informimit ku përcaktohet se: "Rishikimi i programit të transparencës bëhet sipas të njëjtës procedurë përmes së cilës është bërë miratimi i tij. Afatet për rishikimin e programit të transparencës mund të ndryshojë në varësi të natyrës së çdo autoriteti publik, por, në asnjë rast, nuk mund të jenë më të gjata se 5 vjet".

Në vijim të përditësimit të Programit Model nga Komisioneri dhe në zbatim të Urdhrit nr. 281, datë 30.12.2025, Bashkia ka detyrimin ligjor që të rishikojë dhe të miratojë Programin Model të Transparencës në përputhje të plotë me modelin e përditësuar të miratuar nga Komisioneri.

Ndryshimet e reflektuara në Programin Model të Transparencës nuk janë bërë nga Bashkia Belsh, por janë pjesë përbërëse e modelit të përditësuar të miratuar nga Komisioneri, të cilin njësitë e vetëqeverisjes vendore janë të detyruara ta zbatojnë dhe ta miratojnë në organet e tyre vendimmarrëse.

Konkretisht, Programi Model i Transparencës i miratuar nga Komisioneri parashikon këto riorganizime dhe shtesa strukturore:

1. Në PT shtohet një fushë e re, Fusha 8 "Këshilli Bashkiak", dedikuar veprimtarisë së këtij organi të rëndësishëm. Në këtë fushë kërkohet të hidhet informacion lidhur me 8 nënfusha:
 - Informacion rreth këshilltarëve;

- Informacion rreth komisioneve;
 - Kuadri rregullator i këshillit të NJVV;
 - Mbledhjet e Këshillit;
 - Konsultimet publike;
 - Vendimet e Këshillit të NJVV;
 - Kërkesat dhe përgjigjet drejtuar Këshillit të NJVV;
 - Veprimtaria e Këshillit, komunikimi me publikun dhe aspekte të tjera.
2. Fusha 1 "Mbi organizimin dhe funksionimin e bashkisë" riformatohet në 6 nënfusha, pasi nënfushat 2 dhe 3, tashmë përfshihen në fushën 8.
3. Fusha 3 "Për kërkesa për informim" riformatohet në 4 nënfusha:
- Të dhënat e koordinatorit për të drejtën e informimit;
 - Standardet dhe procedurat që duhen ndjekur për të bërë kërkesë për informim dhe ankesës;
 - Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve;
 - Tarifa për dhënien e informacionit
 - (nëse ka);
 -

Rishikimi dhe miratimi i Programit Model të Transparencës nga Këshilli Bashkiak i Belshit ka për qëllim përmbushjen e detyrimit ligjor, harmonizimin e dokumentacionit institucional me aktet nënligjore në fuqi dhe garantimin e një niveli më të lartë transparence ndaj qytetarëve.

Për sa më sipër, propozohet miratimi i projekt-vendimit për rishikimin dhe miratimin e Programit Model të Transparencës të Bashkisë Belsh, në përputhje me modelin e miratuar nga Komisioneri.

Bashkëngjitur do të gjeni një kopje të Programit Model të Transparencës

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin!

Konceptoi:

Koordinatore për të Drejtën e Informimit

Fatmira BROSHKA

